



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
Prishtinë - Prishtina



---

**KOLEGJI "PJETER BUDI" - PRISHTINË**

**RREGULLORE PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË  
CILËSISË, NË KOLEGJIN "PJETER BUDI"**

**Prishtinë, 2020**



Në bazë të nenit 20 të Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi, Bordi Drejtues i Kolegjit me datë 30.09.2020, miratoi këtë:

**RREGULLORE PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË, NË KOLEGJIN  
"PJETËR BUDI"**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1.1 Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e mjeteve dhe procedurave të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe vlerësimit në Kolegjin "Pjetër Budi"

1.2 Qëllimi i sigurimit të cilësisë është krijimi i mekanizmave për promovimin e cilësisë dhe arritje e nivelit më të lartë të cilësisë në aktivitete arsimore, shkencore, artistike, profesionale dhe veprimtaritë administrative në Kolegjin "Pjetër Budi". Në sistemin e sigurimit të cilësisë së arsimit të lartë respektohen specifikat e fushave të veçanta në shkencë dhe në art.

1.3 Kjo rregullore definon mekanizmat dhe proceset e sigurimit të cilësisë bazuar në "Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurim të Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë" (ESG).

1.4 Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohen:

- Qëllimi i Sigurimit të Cilësisë
- Procedurat themelore për sistemin e sigurimit të cilësisë
- Pjesëmarrësit në zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë
- Fushat e sigurimit të cilësisë
- Organizimi dhe veprimi



- 
- Detyrat dhe përgjegjësitë e Rektorit, Pro-Rektorit për Mësim, Hulumtim dhe Zhvillim Akademik, Komisionit Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë, Zyrës për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurim të Cilësisë dhe Hulumtim dhe Udhëheqësve të programeve.
  - Përbërja, mënyra e zgjedhjes dhe mandati i anëtarëve të Komisionit Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë
  - Realizimi i punës nga Komisionit Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë
  - Detyrat e Zyrës për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurim të Cilësisë dhe Hulumtim
  - Implementimi dhe koordinimi i procedurave të Cilësisë
  - Vlerësimi i Brendshëm i sistemit të Cilësisë
  - Roli i pjesëmarrësve në sigurimin e cilësisë
  - Llojet e vlerësimeve në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit
  - Periudha e realizimit të vlerësimeve
  - Shfrytëzimi i të dhënave
  - Rishikimi i rregullores
- Dispozitat shfuqizuese

## Neni 2

### Pjesëmarrësit në zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë

2.1 Bordi Drejtues, Senati i Kolegjit, Rektori, pro-rektorët, Komisioni Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë, Zyra për zhvillim akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim Koordinatori i programit të studimit janë përgjegjës për organizimin e vazhdueshëm të procedurave të sigurimit të cilësisë në Institucion, me qëllim të zhvillimit të një kulture të vazhdueshme të sigurimit të cilësisë.



2.2 Palët e brendshme të institucionit që janë studentët, mësuesit, bashkëpunëtorë dhe staf administrativ, teknik dhe ndihmës të punësuar nga Kolegji "Pjetër Budi" dhe njesitë përberese të tij.

2.3 Palët e interesuara të jashtme: personat juridikë dhe fizikë që lidhen me veprimtaritë e Kolegjit "Pjetër Budi" (për shembull, institucionet e tjerë të sistemit arsimor, ekonomia, administrata lokale dhe shtetërore, alumni).

### Neni 3

#### Roli i pjesëmarrësve në sigurimin e cilësisë

3.1 Bordi Drejtues miraton Rregulloren për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.

3.2 Senati miraton, anëtarët e Komisionit Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë dhe planin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë, sipas propozimit të Komisionit Qendror për Sigurimin dhe Menaxhimin e Cilësisë

3.3 Rektori angazhohet për krijimin e një atmosfere të përshtatshme në institucion për zbatimin e aktiviteteve të jashtme dhe të brendshme për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen financiare për implementimin e këtyre aktiviteteve të ndërlidhura me sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucion.

3.4 Pro-Rektori për Mësim, Hulumtim dhe Zhvillim Akademik udhëheqë Komisionin Qendror të Sigurimit dhe Menaxhimit të Cilësisë.

3.5 Komisioni Qendror i Sigurimit dhe Menaxhimit të Cilësisë përbëhet nga : Prorektori për Mësim, Hulumtim dhe Zhvillim Akademik, Zyrtari nga Zyra për Zhvillim



---

Akademik, ECTS, sigurim të cilësisë dhe hulumtim, 2 koordinator të programeve studimore dhe një përfaqësues studentor. Komisioni takohet së paku dy herë në vjet për të fituar një pasqyrë më të qartë në lidhje me menaxhimin dhe procesin e sigurimit të cilësisë, si dhe të jap rekomandimet e nevojshme për përmirësim.

3.6 Anëtarët e Komisionit, propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati, për një mandat 4 vjeçar.

3.7 Përgjegjësitë e Komisionit Qendror i Sigurimit dhe Menaxhimit të Cilësisë janë:

- Të propozojë Rektorit dhe Senatit një strategji dhe udhëzime të sigurimit të cilësisë, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
- I propozon Rektorit dhe Senatit një plan aktiviteti 5 vjeçar për sigurimin e cilësisë në Institucion;
- Përgatit një raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë;
- Harton instrumentet për vlerësim kualitativ dhe kuantitativ;
- Nxiti inovacionin dhe zhvillimin për të përmirësuar cilësinë;
- Inkurajon në mënyrë të përhershme diskutimet për cilësinë;
- Harton dhe shqyrton raportet e vetëvlerësimit për akreditim institucional dhe të programeve;
- Miraton anëtarët e grupeve punuese për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
- Adreson rekomandimet e japura nga Agjencioni i Akreditimit të Kosovës për akreditim institucional ose akreditim të programeve, përpilon planin e përmirësimit që adresojnë komentet e dhëna dhe ia propozon Rektorit dhe Senatit;
- Udhëheqë procesin e publikimit të raporteve vlerësuese.



**3.5 Zyra për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurim të Cilësisë dhe Hulumtim - Detyrë e Zyrës** është zbatimi i standardeve të cilësisë në Kolegjin "Pjetër Budi" dhe sigurimi mbështetje aktive të Komisioni Qendror i Sigurimit dhe Menaxhimit të Cilësisë dhe njesive perberese në përmirësimin e cilësisë dhe krijimin e një rrjeti të sigurimit të cilësisë në Kolegjin "Pjetër Budi" dhe integrimin e Kolegjit "Pjetër Budi" në një rrjet kombëtar për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të miratuar të cilësisë, veçanërisht aktiviteteve në vijim:

- Organizon në mënyrë të përhershme diskutime mbi cilësinë dhe promovimin e një kulture të cilësisë në botën akademike dhe jo-akademike;
- Mbledh informacione për cilësi nga të gjithë akterët e sistemit, veçanërisht reagimet (feedback) nga studentët dhe mësuesit;
- Organizon zbatimin e proceseve të vlerësimit për cilësinë e punës së mësuesve, punën hulumtuese, shërbimet administrative dhe llojet e tjera të vlerësimit që parashihen më Planin e Veprimit, apo kërkohen nga Menaxhmenti, për nevojat e zhvillimit të përgjithshëm institucional.
- Sipas nevojës trajnon intervistuesit, mbledh e materialet të anketës, përpunon të dhënave, prezenton dhe përcjelle tutje rezultatet e anketës.
- Ofron mbështetje administrative për Komisionin Qendror të Sigurimit dhe Menaxhimit të Cilësisë në procesin e vlerësimit të programeve të reja të studimit si dhe vlerësimin e ndryshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit si dhe në procedurat e vlerësimit të brendshëm periodik.
- Përpunojnë dhe vlerësojnë të dhënat të mbledhura të përmendura në nenin 4 të kësaj rregullore.
- Ofron mbështetje administrative në procedurat e gjyqimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të Cilësisë së Kolegjit "Pjetër Budi".



- 
- Ofron mbështetje ekspertësh për njesite perberesve te Kolegjit "Pjetër Budi" në përmirësimin e procedurave per sistemit e sigurimit te cilësisë në lidhje me zbatimin e vlerësimeve të jashtme.
  - Mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat e nevojshme për përpilimin e Raportit të Vetëvlerësimit.
  - Mbledh, përpunon dhe analizon raportet vjetore dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit te cilësisë se njesive përbërsve të Kolegjit.

3.6 Udhëheqësi i Programit, kujdeset që koordinatori i Zyrës për Zhvillim Akademik, ECTS, Sigurim të Cilësisë dhe Hulumtim realizon përgjegjësitë e veta në lidhje më realizimin e vlereësimit në nivel institucional.

3.7 Udhëheqësi i Programit sigurohet që aktivitetet e vlerësimit brenda njësisë përkatëse realizohen me sukses dhe sipas planifikimit, harton planin e përmirësimit pas zbatimit të aktiviteteve të vlerësimit në lidhje me hapat që duhet ndërmarrë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

3.8 Udhëheqësi i Programit harton Raportin e Vetvlerësimit për akredimi të programit, kontribuon në mënyrë të vazhdueshme për akreditim institucional dhe ne ngritjen e përgjithshme të nivelit të cilësisë në institucion.

#### Neni 4

**Llojet e vlerësimeve në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit**

Kolegji "Pjetër Budi" i realizon këto aktivitete të vlerësimit në vazhdimësi me qëllim të përmirësimit dhe të zhvillimit të kulturës së cilësisë:

- Vlerësimi i aktiviteteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies;



- 
- Vlerësimi i aktiviteteve hulamtuese;
  - Vlerësimi i shërbimeve të administratës dhe shërbimeve të tjera mbështetëse që ofrohen për studentë;
  - Vlerësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar
  - Mbajtja e kontaktit dhe marrja e sugjerimeve nga të diplomuarit për çështje të ndryshme që lidhen me zhvillim e gjithëmbarshtëm të institucionit.

#### Neni 5

##### Periudha e realizimit të vlerësimeve

Vlerësimi i cilësisë së aktiviteteve të cekura në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, bëhet njëherë në vit, apo më shumë, bazuar në nevojat dhe vendimet e ndryshme që merr Menaxhmenti i Institucionit.

#### Neni 6

##### Shfrytëzimi i të dhënave

6.1 Të dhënat nga vlerësimet e ndryshme të parapara me këtë Rregullore, shfrytëzohen për përgatitje të raporteve të vetëvlerësimit me qëllim të akreditimit institucional dhe të programeve nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës, planifikim vjetor dhe strategjik të Institucionit, si dhe identifikimit të ndërmarrjes së hapave të nevojshme për përmirësim të mësimdhënies, mësimnxënies, aktiviteteve hulamtuese, shërbimeve të studentëve si dhe çështjeve të tjera më interes për Institucionin dhe palët e jashtme të interesit.

6.2 Të dhënat e vlerësimit të lëndëve nga ana e studentëve, do të jenë në dispozicion të mësimdhënësve dhe koordinatorëve të programit dhe përdoren për qëllim të përmirësimit së performancës së mësimdhënies dhe avancimin akademik të personelit sipas kritereve të përcaktuara në Statut.





## Neni 7

### Rishikimi i rregullores

Kjo rregullore duhet të rishikohet njëherë në vit, për të qenë në trend me zhvillimet më të fundit në fushën e sigurimit të cilësisë në nivel vendor dhe ndërkombëtar

## Neni 8

### Dispozitat shfuqizuese

8.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja e vjetër për sigurimin e cilësisë.

8.2 Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Drejtues dhe nënshkrimi nga ana e presidentit të bordit të Kolegjit "Pjetër Budi";

8.3 Njesite perberese (akademike) të Kolegjit "Pjetër Budi" janë të detyruara të harmonizojnë rregullat e tyre në lidhje me sistemin e sigurimit të cilësisë me këto Rregullore brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e saj.

  
Kryetari i Bordit  
**Besim AJETI**  


